

Në bazë të dispozitave të Nenit 8 të Ligjit të Punës, Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A Prishtinë, shpall:

## KONKURS

**Pozita:** Zyrtar/e për kontabilitetit dhe analiza financiare

**Lloji i vendit të punës (orari i plotë/jo i plotë):** Me orar të plotë

**Numri i kryerësve:** 1 (një)

**Raportimi:** Udhëheqësit të Divizionit të Kontabilitetit dhe Zyrtarit Kryesor Financiar

*Detyrat dhe përgjegjësitë:*

- *Koordinon dhe është përgjegjës për regjistrimin e të gjithë dokumentacionit në Divizionin e Kontabilitetit;*
- *Bën regjistrimin kontabël të të hyrave dhe shpenzimeve, dhe urdhëresave tjera në softuerin e kontabilitetit;*
- *Bën përcjelljen dhe barazimin e llogarive të arkëtueshme dhe pagueshme dhe përpilon raportet përcjellëse në baza të ndryshme periodike sipas kërkesës;*
- *Mirëmban regjistrin e asetëve fikse, llogarit zhvlerësimin e asetëve dhe bën dorëzimin e regjistrave kontabël tek mbikëqyrësi;*
- *Bën barazimin e llogarive të stoqeve me kontabilitetin financiar;*
- *Mban dhe është përgjegjës për sistemin e kontabilitetit sipas legjislacionit tatimor dhe parimeve të kontabilitetit;*
- *Përgatit deklarinimin e TVSH-së, tatimeve edhe detyrimeve të tjera ligjore brenda afateve të përcaktuara me ligj;*
- *Bën arkivimin dhe sistemin e dokumenteve financiare në kuadër të Divizionit të Kontabilitetit;*
- *Monitoron llogaritë bankare dhe përgatit raporte periodike sipas kërkesës;*
- *Kryen edhe detyra tjera të përcaktuara nga Udhëheqësi i Divizionit apo Departamentit të Financave;*
- *Për punën e tij/saj i raporton Udhëheqësit të Divizionit të Kontabilitetit dhe Zyrtarit Kryesor Financiar.*

*Kualifikimi dhe kushtet tjera të veçanta:*

- *Të ketë të kryer Fakultetin Ekonomik së paku Nivel Bachelor ( Nivel Master i preferueshëm);*
- *Së paku tre (3) vite përvojë pune profesionale;*
- *Njohje shumë e mirë e programeve të MS Office;*
- *Njohja e gjuhës angleze është e preferueshme;*
- *Aftësi të shkëlqyera të komunikimit;*

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në këtë adresë: **Ndërmarrja Publike Banesore - SHA në Prishtinë, Bulevardi "Bill Clinton", p.nr., Prishtinë** ose përmes e-mail-it zyrtar:

[burimet.njerezore@npbanesore.com](mailto:burimet.njerezore@npbanesore.com). Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet ta shënojnë saktë adresën dhe numrin e telefonit kontaktues, si dhe e-mail adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë. Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen. **Konkursi është i hapur nga data 17.12.2016 – 31.12.2016.**